L I G J
Nr.7805, datë 16.3.1994

PËR TATIMIN MBI PASURINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me konceptin e tatimit mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë kuptojmë:
- Tatimin mbi tokën bujqësore.
- Tatimin mbi ndërtesat.

Neni 2

Tatimit mbi pasurinë i nënshtrohen të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas a të huaj, që zotërojnë çdonjërën nga llojet e pasurive të mësipërme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Nga tatimi mbi pasurinë përjashtohet pasuria e zotëruar nga organizmat ndërkombëtarë, në përputhje me konventat ndërkombëtare që i rregullojnë në mënyrë të ndërsjelltë këto përjashtime.

Neni 4

Përjashtohen nga tatimi i papaguar për atë vit personat që janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore si rreshqitje masive të tokës a përmbytje. Këto raste përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 5

Këshilli i Ministrave bën indeksimin e llojeve të tatimit mbi pasurinë një herë në vit, mbi bazën e ndryshimit të çmimit të objektit të tatueshëm. Kriteret caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Të ardhurat e realizuara nga tatimi mbi pasurinë shpërndahen si vijon:
a) buxheti qendror 40 për qind të të gjithë të ardhurave të realizuara;
b) buxheti lokal 60 për qind të të gjithë të ardhurave të realizuara.
Planifikimi dhe shpërndarja e të ardhurave të realizuara nga tatimi mbi pasurinë sipas këtij neni fillon me procedurë të plotë për vitin financiar 1995.

Neni 7

Këshilli i Ministrave cakton fondet përkatëse për krijimin e administratës që do të merret me zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

Ministria e Financave ngarkohet me zbatimin dhe administrimin e tatimit mbi pasurinë. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit detyrohen të vënë në dispozicion të Ministrisë së Financave gjithë dokumentacionin e nevojshëm që do t'u kërkohet për zbatimin e këtij ligji.

KREU II
TATIMI MBI TOKËN BUJQËSORE

Neni 9

Në termin "tokë bujqësore" përfshihen të gjitha sipërfaqet e tokës që janë përcaktuar në nenin 1, shkronja "a" të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

Neni 10

Tokë e tatueshme do të jenë të gjitha tokat bujqësore që sipas klasifikimit të pjellorisë përfshihen nga klasa e parë deri tek e dhjeta.

Tatimi mbi tokën bujqësore llogaritet si vijon:

Tokë bujqësore	klasa 1	6000	lekë/ha
"	klasa 2	6000	" "
"	klasa 3	6000	" "
"	klasa 4	6000	" "
"	klasa 5	4000	" "
"	klasa 6	4000	" "
"	klasa 7	3000	" "
"	klasa 8	2000	" "
"	klasa 9	2000	" "
"	klasa 10	1500	" "

Neni 11

Tatimi mbi tokën bujqësore shlyhet me dy këste gjatë vitit tatimor:

- kësti i parë deri në fund të muajit gusht;
- kësti i dytë deri në fund të muajit nëntor.

Përjashtimisht për vitin 1994 tatimi mbi tokën bujqësore do të derdhet me një këst brenda muajit gusht.

Neni 12

Kur tatimi mbi tokën bujqësore në shkallë vjetore derdhet përpara përfundimit të afatit të këstit të parë (muajit gusht), tatimpaguesi përfiton këto lehtësi tatimore:

a) kur tatimi vjetor mbi tokën bujqësore derdhet deri në 31 maj të vitit tatimor, bëhet zbritje nga tatimi në masën 10 për qind të shumës vjetore të tatimit;

b) kur tatimi vjetor mbi tokën bujqësore derdhet deri në 30 qershor të vitit tatimor, bëhet zbritje nga tatimi në masën 7 për qind të shumës vjetore të tatimit.

c) kur tatimi vjetor mbi tokën bujqësore derdhet deri në 31 korrik të vitit tatimor, bëhet zbritje nga tatimi në masën 5 për qind.

Neni 13

Tatimi mbi tokën bujqësore që nuk shfrytëzohet si e tillë është 10 herë më i lartë.

KREU III
TATIMI MBI NDËRTESAT

Neni 14

Të gjitha ndërtesat që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen tatimit mbi ndërtesat.

Neni 15

Tatimi mbi ndërtesat është vjetor dhe paguhet brenda muajit qershor të çdo viti tatimor.

Neni 16

Masa e tatimit mbi ndërtesat do të llogaritet në lekë për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit.

Neni 17

Për efekt të këtij ligji ndërtesat ndahen në:	Tatimi
I. Ndërtesa banimi:	(lekë/m^2 në vit)
1. në qytet:	
a) banesa të veçanta	6
b) banesa në bashkëpronësi	4
2. në fshat	3
II. Ndërtesa për shërbime shëndetësore, artizanale e komunale.	20
III. Ndërtesa tregtie dhe shërbimesh të tjera.	100
IV. Ndërtesa për veprimtari prodhuese.	50
V. Ndërtesa me karakter publik si ato të administratës shtetërore,socialkulturore, shëndetësore, arsimore, sportive e kulteve fetare.	2

Neni 18

Përjashtohen nga tatimi ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësit me qira të paliberalizuara.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Subjekte të tatimit për tokën do të jenë edhe familjet me pak të ardhura që përfitojnë ndihmë ekonomike. Shteti kompenson 100 për qind të masës së tatimit për këto subjekte.

Neni 20

Konsiderohen shkelje të këtij ligji:

1. Mosdeklarimi i çdo pasurie që tatohet sipas këtij ligji dhe mosparaqitja në organin tatimor brenda afatit të caktuar për:

a) tokën bujqësore,

b) ndërtesat e banimit,
c) ndërtesat e tregtisë, shërbimeve e të aktivitetit prodhues dhe ato me karakter publik.
2. Falsifikimi i dokumenteve që vërtetojnë pasurinë.
3. Mosderdhja në afatet e caktuara e tatimit mbi pasurinë.

Neni 21

Shkeljet e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me këto masa:
- Për shkeljet e pikës 1.a) me gjobë 2000 - 4000 lekë.
- Për shkeljet e pikës 1.b) me gjobë 1000 - 2000 lekë.
- Për shkeljet e pikës 1.c) me gjobë 8000 - 10000 lekë.
- Për shkelje të pikës 2 me gjobë 20000 - 30000 lekë
- Për shkeljet e pikës 3 me gjobë 2000 - 4000 lekë.

Neni 22

Të drejtën e gjobës për shkeljet e kryera nga paguesit e tatimeve e kanë inspektorët dhe drejtuesit e organeve tatimore.
Ankimi bëhet sipas ligjit "Për kundravajtjet administrative".

Neni 23

Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij ligji.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.804, datë 31.3.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.